

TEKI KURTI**MBI VEPRIMTARINË E QEVERISJES VENDORE
NË VITET E MONARKISË SHQIPTARE
(1928-1938)**

Burimet që hedhin dritë mbi organizimin dhe veprimtarinë e qeverisjes vendore janë të shumëllojshme, të karakterit të mirëfilltë dokumentar dhe bibliografik. Ndërmjet tyre përmendim botimin “10 Vjet Mbretëri 1928-1938”.¹

Ky botim me referencë burimet zyrtare të kohës, siç janë raportet, dokumentet statistikore me të dhëna konkrete të secilit dikaster apo drejtori të përgjithshme, dëshmon për punë me përgjegjësi, në përmbajtje dhe formë për paraqitjen e gjendjes reale, pa zbulime.²

Përgatitësit e këtij botimi u referohen edhe të dhënave nga burimet e tjera duke plotësuar të dhënat që mungojnë në raportet zyrtare. Kështu ata demonstrojnë përgjegjësinë e tyre, për të paraqitur një studim real, të mbështetur në fakte, dokumente dhe publikime “të mirë kontrolluara”.

Vlera dokumentare e këtij burimi historik shtohet akoma më tepër me pamje vizuale që përfshihen në të, si: *fotografi origjinale të objekteve dhe të personave privatë*, që mund të konsiderohen në vetvete si dokumente të vlefshme historike. Ky burim ka shërbyer për studimin tim, si bazë për të shfrytëzuar të dhëna e fakte që flasin edhe për qeverisjen vendore gjatë kohës së Monarkisë Shqiptare (1928-1938).

Periodha e Mbretërisë Shqiptare dallohet për arritjet e saj duke e krahasuar me periudhën e mëparshme. Duke përdorur si bazë metodën krahasuese të një etape me atë paraardhëse, autorët e botimit të sipërpërmendur, arrijnë në përfundimin bindës se *Shqipëria e Mbretit Zog, gjatë këtyre dhjetë vjetëve, është ndryshuar rrënjësisht nga një shtet me shumë plagë dhe me shumë mendësira të ndryshuara, në një shtet të shëndoshë dhe të shëndetshëm i rritur me një frymë të gjallë oksidentale*.³

¹ *10 Vjet Mbretëri 1928-1938*, Tiranë: Shtypshkronja Tirana, 1938.

² *Po aty*, f. XIX.

³ *Po aty*, f. XX.

Duke marrë parasyh faktin se në botime të tilla evidentohen sa më shumë arritje në politikë dhe në realizimin e një qeverisje të mirë, ata kanë vlerë se iu përgjigjen interesave mbarëkombëtare.

Botimi, si ky që po flasim, shpalosin qëndrime e sjellje që lidhen me kulturën politike të elitës qeverisëse, pra edhe motivet nga udhëhiqen qeveritarët në veprimtarinë e tyre dhe në synimet që orvaten të realizojnë.

Botimi “10 Vjet Mbretëri”, që i referohet një periudhe historike, ku vihet në dukje roli i një personaliteti politik, nuk mund të shmangte konsideratat e përgjithshme për Mbretin, formimin e tij si personalitet shtetëror, vendin dhe rolin e tij në kontekstin e zhvillimit historik të qeverisjes në Shqipëri, si dhe ndikimi në qeverisjen vendore.

Në këtë kuadër trajtohet vendosja e mbretërisë si formë qeverisjeje, si një domosdoshmëri për kapërcimin e gjendjes arkaike, konfuzionin, grindjet e luftën e paprincipitë për pushtet.

Vend të rëndësishëm zë trajtimi i strukturës institucionale të mbretërisë, raporti ndërmjet organeve të ndryshme të qeverisjes qendrore dhe atyre vendore. Në mënyrë të veçantë trajtohen kompetencat e Mbretit me rolin e madh përcaktues e vendimtar të tij në veprimtarinë qeverisëse në të gjitha nivelet.

Ndërkaq hidhet ideja për fillimin e dinastisë mbretërore, duke iu referuartributeve të domosdoshme për një dinasti, që nga zotërimet e pasurive, përbërjen familjare dhe autoritetin e tij mbarëkombëtar. Po ashtu, veçohet formimi politik i Mbretit dhe aftësitë e tij statistike, organizative e drejtuese të shprehura shumë kohë përpara ardhjes në fron. Në këtë kuadër zë vend të rëndësishëm edhe mbretëresha dhe cilësitë e mbretëreshës, që kishte rolin e saj në strukturat qeverisëse të Monarkisë.

Botimi “10 vjet Mbretëri 1928-1938” paraqet vlera për qeverisjen vendore në drejtimet e mëposhtme:

- Në organizimin administrativ të qeverisjes në prefektura, nënprefektura, bashki e komuna. Ai ofron njohuri të sakta për evidentimin e strukturave të qeverisjes vendore.
- Në pasqyrimin e gjendjes dhe shpërndarjes së burimeve për zhvillimin e vendit në tri format: natyrore, njerëzore dhe kapitale. Njohja e këtyre burimeve është e rëndësishme për të kuptuar përmbajtjen e politikave dhe të efektshmërisë së qeverisjes.
- Në parashtrimin e treguesve demografikë, që janë të një rëndësie të veçantë në menaxhimin e burimeve.

- Në ofrimin e të dhënave për zyrtarë të veçantë, të cilët kanë qenë në krye të organizmave të qeverisjes vendore. Ata sjellin njohuri për korpusin e tyre profesional, për mënyrën e formimit dhe të ecurisë së tyre në veprimtarinë pushtetore.

Kuptohet që, peshën kryesore për organizimin dhe veprimtarinë e organeve të qeverisjes vendore për arritjet e tyre e mban Ministria e Punëve të Brendshme me organizimin dhe funksionimin e saj.

Roli i veprimtarisë së Ministrisë së Punëve të Mbrendshme (Brendshme) merr rëndësi, jo vetëm si organi i sigurisë së rendit e të jetesës, të zbatimit të ligjit, në përgjithësi por edhe në drejtim të realizimit të qeverisjes vendore sipas motos: *“shteti sundon, shteti vepron, shteti ka tagër dhe të drejtë që të dënojë e të falë”*.⁴

Në këtë periudhë historike roli i shtetit është më i plotë. Kështu, koncepti i shtetit lidhet ngushtë jo vetëm me zbatimin e ligjit, por edhe bindja e qytetarëve për zbatimin e tij.

Dihet se një qeverisje e qendëruar ishte e domosdoshme për t'i dhënë fund atij copëzimi shekullor që ngjallte dyshime, mosbesim e konflikte.

Me mjaft interes, në këtë drejtim, shihen reformimet në qeverisjen vendore, sipas të cilave ndodhi shndërrimi i pleqësive në kryepleqësi dhe shndërrimi i krahinarive në nënprefektura dhe prefektura.

Një drejtim të veçantë për reformimin e qeverisjes vendore përbëjnë marrëdhëniet ndërmjet organeve qendrore dhe atyre vendore. Dukej se organeve qendrore e sidomos Ministrisë së Punëve të Brendshme i qe dhënë një rol vendimtar në sigurimin e unitetit mbarëkombëtar, në zbatimin strikt të ligjit, me synimin që *“i gjithë vendi të gjindej i lidhur nën një autoritet (autoritet) që ndjehej gjithmonë pranë dhe kudo i gatshëm për të rikthyer rregullën dhe disiplinën, atje ku rregulla dhe disiplina prishej”*.⁵

Për të realizuar një funksion të tillë në dikasteret qendrore duhej forcuar prirja për të kaluar në forcimin e qeverisjes vendore nëpërmjet prefekturave, nënprefekturave, bashkive e komunave.

Momenti i rëndësishëm në këtë proces përsosjeje të qeverisjes vendore ishte organizimi administrativ i qarqeve deri më 31 mars të vitit 1929. Kjo do të thoshte që prefektura, nënprefektura e krahina, të

⁴ *Po aty*, f. 219.

⁵ *Po aty*, f. 231.

riorganizoheshin dhe në veprimtarinë e tyre, të zbatonin kompetencat, “të cilat rregulloheshin me ligjin e administratës civile të 21 majit të vitit 1928 dhe mbështetej në ligjin organik. Sipas këtij ligji Shqipëria ndahej në 10 prefektura e 29 nënprefektura, të kategorizuara në dy klasa. Gjithashtu, sipas këtij ligji vepronin në vend, 63 krahina të ndara në tri klasa të cilat përfshinin 2361 katunde”.⁶

Procesi i riorganizimit të organeve të qeverisjes vendore pati ndryshime të njëpasnjëshme, që u diktua nga nevoja për ta përsosur atë në kushtet e vendit tonë. Për këto ndryshime u patën parasysh dhe traditat e marrëdhënieve të njësive vendore me njëra-tjetrën për t’iu përshtatur sa më mirë dhe mundësive të pushtetit qendror në lidhje me zbatimin e ligjeve dhe të akteve nënligjore që miratoheshin nga organet qendrore shtetërore. Kështu ndodhi me ligjin e 30 prillit të vitit 1935, sipas të cilit, organizatat komuniste u suprimuan 52, nga 192 që ishin më parë. Gjithashtu, sipas këtij ligji, qendrat e nënprefekturave iu aneksuan bashkive të qyteteve. Si rezultat u suprimuan 8 nënprefektura. Më vonë, me ligjin e 6 qershorit të vitit 1938, këto nënprefektura u rikrijuan.⁷

Përsosja organizative e organeve të qeverisjes vendore u shoqërua me zgjerimin e kompetencave të tyre. Kuptohet, që një gjë e tillë, lehtësoi trajtimin e shumë çështjeve të komunitetit, të cilat më parë, zgjidheshin nga organet larg qendrave të banuara. Në përmbajtjen e vendimeve të qeverisjes vendore dukej qartë synimi për realizimin e një qeverisje moderne, gjë që duket në: pjesëmarrjen e të qeverisurve në organet e zgjedhura dhe në rritjen e interesimit të qytetarëve për qeverisjen.

Prirja për të realizuar një qeverisje moderne, me synimet e mësipërme, shprehej si nevojë, për të pasur “në krye autoritetet që përfaqësojnë fuqinë e shtetit dhe këshillin e zgjedhur prej vetë popullsisë së vendit”⁸ dhe për realizime “që nuk do të kryheshin, ndoshta po të mos kishte qenë interesue vetë katundari për to”.⁹

Drejtimi tjetër i punës, për të përsosur qeverisjen vendore moderne lidhej me zgjedhjen e kuadrit që të ishte sa më profesional. “Nuk duhet harrue se këta ofiqarë (kupto: kuadro gjenden në kontakt të ngushtë me popullin dhe se u përket atyre barra e rëndë që t’i japin këtij (popullit –

⁶ *Po aty*, f. 233.

⁷ *Po aty*.

⁸ *Po aty*, f. 234.

⁹ *Po aty*.

T.K.) përkrahjen e duhun në çdo fushë përparimi dhe zhvillimi kulturuer, moral, hygienik, shoqënuer, ekonomik e tjera”.¹⁰

Reformimi i qeverisjes vendore nuk ishte qëllim në vetvete, por ishte në funksion të nevojave të shfaqura për përmirësimin e shërbimeve ndaj komunitetit, të sigurimit të të ardhurave për përballimin e shpenzimeve për zgjidhjen e nevojave të popullsisë së njësisë që mbulonte qeverisja vendore.

Rritja e veprimtarisë së qeverisjes vendore u shpalo dhe në fushën sociale, ku spikat rritja e popullsisë nga 814.380 në vitin 1923 në 1.037.857 frymë në vitin 1938.¹¹

Tregues me rëndësi për rritjen e veprimtarisë së qeverisjes vendore duken qartë në të dhënat për zhvillimin e prefekturave, të cilat janë pasqyruar në botimet e kohës nëpërmjet fotografive të shumta të objekteve, mjaft prej të cilave ruhen edhe sot.

Shumë fakte e dokumente, midis të tjerave, dëshmojnë për shkallën e zhvillimit ekonomik, përparimet në fushën e ekonomisë sidomos në fushën e shoqërisë urbane me tërë tiparet karakteristike të një shoqërie moderne. Dallojmë në mënyrë të dukshme investimet e bëra sidomos në vepra publike në qytete.

Forma politike e Monarkisë si një qeverisje e qendëruar bën që investimet të jenë rezultat i nxitjes dhe i orientimit të qeverisë qendrore.

Në raport me qeverisjen vendore investimet e realizuara nga qeveria qendrore zinin, padyshim peshën më të madhe të tyre. Kjo për faktin që ende burimet e të ardhurave të qeverisjes vendore ishin të kufizuara. Drejtimi më i rëndësishëm i investimeve ishin ato që shkonin për vepra infrastrukturore nga të cilat përfitonin, në radhë të parë, organet e qeverisjes vendore. Ata do të organizonin realizimin e tyre me sigurimin e fuqisë punëtore, gjë që çonte në rritjen e gjendjes ekonomike e sociale të komunitetit.

Drejtimet kryesore të investimeve ishin për ndërtimin e rrugëve ku mbizotëronin ato me kalldrëm, ndërtimin e urave, duke shfrytëzuar dhe mundësitë rrethore si dhe në ndërtimin e limaneve të vegjël.

Drejtim tjetër i investimeve ishte ai që i kushtohej bujqësisë, realizimi i të cilave ndërthurte qeverisjen qendrore me atë të qeverisjes vendore. Kusht i domosdoshëm për realizimin e investimeve ishte hartimi i kuadrit

¹⁰ *Po aty*, f. 135.

¹¹ *Po aty*, f. 236.

ligjor për bujqësinë, ku vend të rëndësishëm zinin ligjet mbi marrëdhëniet pronësore, mbi shpërndarjen dhe shtetëzimin e burimeve natyrore, si: pyjet, kullotat, ujërat, menaxhimi i inventarit bujqësor, mbi fondet e zhvillimit, mbi gjendjen e kulturave bujqësore si ulliri, pemët frutore, hardhitë e vreshtat, duhani, bimët leguminore, orizi, bimët industriale, pambuku, recini, mëndafshi si dhe rritja e bletës. Ky legjislacion kishte të bënte me veprimtarinë e drejtorisë së ujërave, me atë të veterinarisë dhe të zooteknikës si dhe zhvillimin e tregtisë bujqësore. Mbi baza ligjore u vendos edhe organizimi i ndërmarrjeve të kërkimeve dhe studimeve shkencore në bujqësi si dhe i arsimit bujqësor. Ndërmarrje të tilla të organizuara mbi ligjet e miratuara, ishin fermat moderne kapitaliste si ajo e Xhafzotaj dhe e Golemit. Ato u bënë shembuj të zhvillimit kapitalist të bujqësisë në Shqipëri.

Në shqyrtimin e veprimtarive dhe të arritjeve të qeverisjes vendore janë marrë në konsideratë dy drejtime themelore:

- Tiparet e përgjithshme të zhvillimit ekonomik të vendit nëpërmjet të cilave pasqyrohet edhe shkalla e zhvillimit të shoqërisë shqiptare.

- Tiparet e zhvillimeve qendrave urbane dhe rurale mbështetur në të dhënat konkrete për ndërtimin e veprave publike, të banesave, të parqeve, të bulevardëve e të veprave komunale si ujësjellësa dhe kanalizime. Analiza e shqyrtimi i këtyre drejtimeve hedh dritë mbi veprimtarinë e qeverisjes vendore. Nga veprimtaria e pushtetit vendor në zonat rurale, ku ndjehej përgjegjshmëria e tij raportoheshin si arritje ndërtimi i rrugëve, kanaleve, i blloqeve me pemë, ullishte, etj. Ishte bërë një praktikë normale që analiza e veprimtarisë së pushtetit vendor të bëhej sipas një strukture të përcaktuar qartë, e cila mbulonte veprimtarinë e njësisë së qeverisjes vendore përkatëse.

I. Gjendja ekonomike

a. bujqësia

b. blegtoaria

II. Arsimi

III. Aktiviteti botuer (punët botore), ku trajtohen: godina sociale e shkolla, rrugë të reja, parqe dhe kopshte, banjo publike, plazhi, varrezat etj

IV. Shëndetësi

V. Gjendja shoqërore

Duke iu përmbajtur një strukture të tillë analiza nxirrte në pah jo vetëm arritjet por edhe mangësitë e njësisë së qeverisjes vendore. Një gjë

e tillë orientonte organet qendrore të qeverisjes, për të përmirësuar dhe ata metodën e qeverisjes, duke nxjerrë përgjegjësitë.

Paraqitja e arritjeve sipas prefekturave, nënprefekturave, bashkive dhe komunave, njëherazi ishte tregues i realizimit të politikave qeverisëse në shkallë vendore, të cilat njiheshin si “vepra bashkiake dhe komunale”.

Vetëkuptohet që në vlerësimin e rezultateve të qeverisjes vendore, merreshin parasysh edhe disa faktorë objektivë që ndikonin, siç ishte pozicioni gjeografik i njësisë vendore me minuset dhe planet e shkallës së marrëdhënieve ekonomike, gjendja dhe llojet e burimeve natyrore, tradita e zhvillimit historik, përbërja sociale e popullsisë, shkalla arsimore kulturore si dhe botëkuptimore e saj.

Për të pasur parasysh rezultatet e qeverisjes vendore, po japim më poshtë disa nga këto tregues sipas prefekturave të Shqipërisë, ku dallohen qartë dhe specifikat e qeverisjes vendore.

Prefektura e Beratit

Karakteristikë kryesore e arritjeve në këtë njësi është përdorimi i teknikave dhe metodave tradicionale, ato të teknikave më të përparuara në bujqësi. Prirja e zhvillimit ishte prodhimi për treg. Ndër këto tregues vihet re zgjerimi i sipërfaqes së tokës të punueshme dhe i varieteteve të kulturave bujqësore të kultivuara. Rezultatet në këtë drejtim janë kushtëzuar dhe me shërbimet e ofruara nga qeverisja qendrore për organet vendore.

Rezultatet e qeverisjes vendore vihen re në zhvillimin e arsimit, me hapjen e shkollave të reja, organizimin e kurseve kundër analfabetizmit etj.

Me investimet e bashkisë së Beratit, u realizua ndërtimi i fushës së sportit, i parkut publik me një sipërfaqe 25.600m², i monumenteve si Baba Dudë Karbunara, të ambulancës dhe kurora e ullishteve.

Roli i pushtetit vendor u evidentua dhe në njësitë e tjera të qeverisjes vendore si: në komunat e Qendrës, të Peshtanit, Molishtit, të Urës së Hasan Beut (Kuçovë), të Roskovecit, të komunës së Klasit I të Ballshit (me komunat e Cakranit, Fratarit, Qendër), të nënprefekturës së Skraparit dhe asaj të Fierit (me bashkinë, komunën e Semanit, të Levanit), nënprefektura e Lushnjës (Qendra, Karbunarë, Divjakë, Libofshë, Bumbullimë, Fier-Sheganit), ku u realizuan vepra publike si: ndërtimi i rrugëve komunale me përmasa të përparuara për kohën, ndërtimi i kanaleve të madhësive të ndryshme, ndërtimi i urave, ndërtimi dhe

rikonstruksioni i objekteve shkollore në disa qendra vendore, ndërtimi i tregjeve lokale sipas nevojave, si dhe hapja e puseve, etj.

E veçanta për njësitë vendore të prefekturës së Beratit ishte krijimi i blloqeve me ullishta si dhe i fidanishteve¹², duke i dhënë impuls zhvillimi një tradite shekullore të kësaj prefekturë.

Prefektura e Dibrës

Rezultatet e qeverisjes vendore dalin në dritë në fushën e bujqësisë, ku vihet re përdorimi i teknikave më moderne, i farërave të zgjedhura, krijimi i fidanishteve (nëntë të tilla) dhe ndërtimi i rrjetit vaditës. Vëmendje e veçantë iu kushtua përdorimit të metodave më të përparuara në blegtori. Institucionet financiare rritën dhënien e kredive bujqësore.

Veprimtaria në fushën e arsimit paraqitet si drejtim i dytë i investimit të qeverisjes vendore.

Investimi në infrastrukturë, i njohur si veprimtari “botore” u konsiderua si kusht për “*lehtësimin e marrëdhënieve ekonomike, kulturore, shoqërore*”. Rezultatet në këtë fushë ishin inkurajuese. U ndërtuan 150 km rrugë komunale, 45 ura, vija ajrore Tiranë - Peshkopi, (tre herë në javë), furnizimi me ujë (ndërtimi i 16 çezmave) dhe ndërtimi i spitalit në vend të dispanserisë, që ekzistonte më parë.

Spikati në këto vite veprimtaria e organeve të qeverisjes vendore në “ndryshimin e gjendjes shoqërore”, në drejtim të luftës kundër zakoneve prapanike siç ishin: shitja e vajzave, shpenzimet e tepërta për festa, dasma, vdekje, lufta kundër analfabetizmit, “zbulimi i fytyrës së femrës” etj. Në qendër të prefekturës e në komunat e saj ishin ngritur shoqatat “Gruaja shqipëtare” etj.¹³

Prefektura e Durrësit

Realizimet e qeverisjes vendore ishin të lidhura me kryerjen e investimeve në disa objekte të rëndësishme, komunale, që ndikonin në ndryshimin e nivelit të jetesës në komunitet. Kështu u ndërtua godina e pallatit të ri të bashkisë, e doganës etj.; u ndërtuan rrugë të reja si: Bulevardi Zogu I, rruga Mbretëresha Geraldinë si dhe zgjerimi i rrugëve ekzistuese. Ndryshoi pamja e qytetit me ndërtimin e parqeve dhe e

¹² *Po aty*, f. 239-251.

¹³ *Po aty*, f. 251-259.

kopshteve, si ai në sheshin e Lirisë etj. Përveç këtyre u ndërtuan banjo publike, varrezat e reja, etj.

Për vetë pozicionimin e prefekturës, si njësi vendore bregdetare, iu kushtua vëmendje investimeve në plazh, si: ndërtimi i banjove, lulishteve, magazinave etj.

Investime të dukshme u bënë dhe në komunat e Shën Vlashit, Ndroqit, në komunën e Klasit I Shijak, të Prezës, të Ishmit, në nënprefekturën e Krujës si dhe të Qendrës, në komunën e Kurbinit (të Mamurrasit dhe të Benës); në nënprefekturën e Kavajës (në komunat Harizaj e Kryevidh). Investimet u përqendruan kryesisht në këto drejtime: në ndërtimin e rrugëve të përmasave të ndryshme, ku veçojmë rrugën e re të Adriatikut, atë të Sarajt, 1 Shtatori, 8 Tetori, të Tabakëve, të Shën Premtes; në hapjen e kanaleve, sidomos në zonat moçalore; në godinat shkollore; në krijimin e pemëtoreve e të frutoreve; në ndërtimin e ambulancave në qytetet e Krujës, të Shijakut e të Kavajës.¹⁴

Prefektura e Elbasanit

Investimet në këtë prefekturë u bënë në objekte që i përgjigjeshin një shkalle të përparuar të zhvillimit, si në ndërtimin e teatër-kinemasë, të centralit elektrik, si dhe të ndërtimit të fabrikave të vajit e të alkoolit.

Për vetë shtrirjen gjeografike të prefekturës së Elbasanit vend i rëndësishëm iu kushtua zhvillimit të kulturës së ullirit në blloqe (8.000 rrënjë ulliri) e të fidanishteve (20 dynym me afro 50 mijë fidanë).

Si në çdo prefekturë tjetër, qeverisja vendore arriti rezultate në fushën e ndërtimeve si dhe në rrugët e urat.¹⁵

Prefektura e Gjirokastrës

Veprimtaria e qeverisjes vendore u dallua sidomos në fushën e arsimit. U rrit numri i shkollave (20 shkolla të reja, përfshirë gjimnazin), u rrit personeli mësimor (53 arsimtar të rinj), u shtuan pajisjet shkollore u organizuan kurset për luftën kundër analfabetizmit, me pjesëmarrjen e grave dhe vajzave (450 gra e vajza). Në këto vite u ndërtua monumenti i Çerçiz Topullit në qendër të prefekturës.

Investime u bënë në shëndetësi si, ndërtimi i spitalit me repartin e kirurgjisë etj.

¹⁴ *Po aty*, f. 259-268.

¹⁵ *Po aty*, f. 269-271.

Veç këtyre sa përmendëm, interesimi i qeverisjes vendore u shpreh në zhvillimin e bujqësisë, për ndërtimin e veprave botore, për ndërtimin e rrugëve e të urave. Si vepra të bashkisë dhe të komunave, spikatin: ndërtimi i rrugës së Konispolit 40 km, që lidh Delvinën e Sarandën me Konispolin, Borsh-Kullarat (34 km), Veliqot -Fratar (28 km), Isare - Gusmar (18 km), Dhuvjan-Poliçan- Hasan Dodë (63 km), Ur Drin - Hoshtovë (33 km), Urë Kserja-Sotire (14 km), Muzinë-Dhrovjan (10 km), Sarandë-Butrint (17km), si dhe urat e Përmetit, e Dragotit me konstruksion metalik, e Kardhiqit, Borshit, Bodrishtës, Turanit, Salarisë, Sinanajt, Goranxisë, Luzatit, Subashit etj.¹⁶

Prefektura e Korçës

Investimet në këtë prefekturë u përqendruan kryesisht në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë, nisur dhe nga kushtet natyrore të përshtatshme. Rezultate të dukshme pati dhe në objektet social-kulturore si ndërtimin e godinave të prefekturës, të bashkisë, të bibliotekës, të spitalit, të jetimores, të shkollës teknike, të Liceut, të kishës katedrale e të metropolisë, të bankës kombëtare, të sheshit të qytetit dhe të tregut etj. Gjithashtu u ndërtuan objekte kulturore, si godina e sahatit, statuja e Luftëtarit Kombëtar e Themistokli Gërmenjit, Spiro Ballkamenit, Lëndina e Lotëve, sheshi sportiv etj.

Prefektura e Korçës dallonte nga të tjerat në zhvillimin e industrisë e përfaqësuar me fabrikën e birrës, të trikotazhit, të kauçikut, të lëkurës, të stofrave të leshta, të bojrave, të përpunimit të leshit, të mëndafshit artificial dhe të shkrirjes së metaleve.

Përveç qendrës së prefekturës, u ndërtuan shkolla të reja në komunat e Qendrës, me 10 shkolla të reja, në Bulgarec, Rembec, Vinçan, Polenë, Qatram, Rovonik, Trestenik, Goskovë, Drenovë, Boboshticë si dhe rrugë e çezma, në komunat e Dardhës (ku ndihej edhe kontributi i qytetarëve korçarë në mërgim), e Lavdar-Oparit, e Maliqit, e Pojanit, e Gllomeshit, e Voskopojës, e Vithkuqit.

Me investimet e pushtetit vendor komunat u lidhën me rrugë me njëra-tjetrën, të cilat patën përfitime të ndërsjella, sidomos në përfshirjen e fëmijëve në shkolla.

Veçori patën investimet në komunën e Voskopojës, të cilat u orientuan për shfrytëzimin e saj si qendër turistike e kurative për

¹⁶ *Po aty*, f. 272-276.

sëmundje të veçanta, ku u ndërtuan rrugë, godina, çezma, lulishte (parku “Skënderbeu”) etj.

Në nënprefekturën e Kolonjës (me komunat e Qendrës, Barmashit, Qafëzezit) qeverisja vendore ndërtoi objekte administrative si dhe rrugë, ura etj.

Nënprefektura e Pogradecit, ndryshoi pamjen e qytetit me ndriçimin elektrik, me ndërtimin e bulevardit buzë liqenit, me ndryshimin e shtratit të lumit, me ndërtimin e çezmave e të përmendoreve etj. Qendra e nënprefekturës u lidh me komunat e tjera si, ajo e Çërravës, e Moçanit e Pleshishtit. Kurse nënprefektura e Bilishtit realizoi lidhjet me komunën e Bozhigradit, Hoçishtit e Progrit. Ndërsa ajo e Leskovikut u lidh me komunën e Kovaçishtit.¹⁷

Prefektura e Kosovës

Veprimtaria e qeverisjes vendore në këto njësi u përqendrua në vendosjen e rendit dhe të qetësisë publike, në forcimin e punës për zbatimin e ligjeve nga qytetarët. Rezultatet e kësaj pune u dukën në dorëzimin e armëve, në pakësimin e vrasjeve e të plaçkitjeve, pa hequr vëmendjen nga problemet që lidheshin me zhvillimin ekonomik të prefekturës. Përqendrimi i punës së qeverisjes vendore në zbatimin e ligjeve synonte në “njësimin e të gjithëve para ligjeve e para autoriteteve” që ai të ishte i plotë. Për rrjedhojë influenca e parive në këto male, “të mbetej një kujtim historik” siç thuhej në relacionet për këtë veprimtari.

Rezultatet e qeverisjes vendore u shpalosën në ndërtimin e objekteve administrative e shkollore, të veprave botore (rrugë, ura) në komunat Nikaj-Mërtur, Bytyçi, Krasniqe, Qendër Tropojë, Qendër Kukës, Has e Krumë, Lumë, Gorë, Kala e Dodës, Bicaj.¹⁸

Prefektura e Shkodrës

Veprimtaria e qeverisjes vendore në këtë njësi spikati në zhvillimin e arsimit që nga niveli fillestar, deri në arsimin e mesëm. U ngrit gjimnazi “28 Nëntori”, shkolla e Dogajve, shkolla Femnore për të cilat u ofruan edhe bursa.

¹⁷ *Po aty*, f. 277-305.

¹⁸ *Po aty*, f. 306-317.

Në nënprefekurat u ndërtuan 28 shkolla të reja. U organizuan aktivitete kulturore mbi bazë organizate apo shoqate si ajo me emrin “Vllaznia”.

Investimet e qeverisjes vendore u orientuan dhe në vepra të tilla, si: thertorja, banjo publike, parku i bulevardit Zogu I, sheshe, zgjerimi i bulevardit etj.

Investimet për zhvillimin e bujqësisë u orientuan në futjen e teknikave të përparuara, si: farëra të zgjedhura (Mentana, Rieti, Cologna, Capelli Marton, Legang, Billi) dhe mbarështim të pyjeve etj. Pati investime, kryesisht në punime botore, në komunat dhe nënprefekurat si: Bushati, Vraka, si nënprefektura e Pukës, komuna e Va-Spasis, nënprefektura e Koplikut me komunat Shkrel, Postribë, Kastrat, Vermosh, nënprefektura e Dukagjinit, nënprefektura e Lezhës me komunat e Zadrimë, Bregu i Matës, Shëngjin, nënprefektura e Mirditës me komunat Qendër, Dibri, Fan, Spaç, Pulaj.¹⁹

Prefektura e Tiranës

Veçoritë e kësaj prefekturë ku ishte dhe kryeqyteti i vendit Tiranë, si qendër kryesore administrative, kulturore, shoqërore, financiare etj., kërkonin një gërshetim më të organizuar të veprimtarisë qeverisëse të administratës qendrore me atë të organeve qeverisëse vendore. Tirana u bë nyja ku kryqëzoheshin rrugët nga Veriu e Jugu i shtetit shqiptar.

Kështu përfundoi rruga Tiranë-Elbasan (55 km), gjë që lehtësoi edhe lidhjen me Korçën. U bënë investime në rrugët e bulevardet e Tiranës, për t’i dhënë pamjen e një qyteti modern..

Investime, ndonëse jo në masën e duhur, u bënë në komunat e Shënpalit, Vorës, Priskës, Shëngjergjit e Petrelës.²⁰

Prefektura e Vlorës

Roli i qeverisjes vendore u përcaktua nga nevoja e peshës që kishte Vlora si qytet port. Kështu u bënë investime në molon e portit me një gjatësi 156 m, u ndërtuan disa rrugë, madje edhe vija dekovili në qytet, për t’u lidhur me Nartën, Ujin e Ftohtë. Përveç lulishteve, u ngrit muzeu kombëtar “Zogu I” në ish banesën e Ismail Qemalit.

¹⁹ *Po aty*, f. 318-337.

²⁰ *Po aty*, f. 338.

Një peshë të rëndësishme të investimeve mbahej nga kapitali privat tregtar si në ngritjen e dyqaneve ashtu dhe në punishtet për përpunimin e lëndëve të para bujqësore e blegtorale. Siç duket iniciativa private në këtë qytet ishte nxitur dhe përkrahur nga institucionet e qeverisjes vendore.

Për lidhjen e komunës së Nartës, me fshatrat e saj u ndërtuan rrugë në fshatrat Zvërnec, Panaja, Goricë e Mifolit në rrugën “Novoselë-Ehuke”, Gemija e Shkëmbit-Bunavi (4000 m), në Drashovicë, rrugë (2600 m), në Muzhar (6 km) që lidhte fshatrat Drashovicë, Vodice, Lapardha e Mazhar, si dhe urat (në Mavrovë). U ndërtuan ndërtesa shkollore në disa komuna.

Në vëmendje të qeverisjes vendore ishin investimet në kultivimin e ullirit, duke rritur numrin e rrënjëve të tyre. Rezultat i kësaj veprimtarie ishte krijimi i “ullishteve komunale”.

Nga analiza e veprimtarisë qeverisëse, ku kemi parasysh edhe bashkëveprimin e organeve qendrore me organet vendore të qeverisjes, gjatë periudhës historike të Monarkisë Shqiptare, mund të arrihet në disa përfundime.

Drejtimi qendror i veprimtarisë qeverisëse, përfshirë dhe qeverisjen vendore ishte vendosja e rendit dhe stabilitetit politik dhe ekonomik në gjithë vendin.

Vendin e anarkisë, të vetë-gjyqësisë, të zbatimit të normave zakonore e patriarkale, e të autoritetit të bajraktarëve, e zuri zbatimi i ligjit dhe filloi funksionimi i shtetit ligjor.

Mbi bazën e funksionimit të ligjit u krijuan marrëdhënie të reja nëpërmjet organeve të qeverisjes dhe të qeverisurve, të cilat çuan në forcimin e legjitimitetit të rendit qeverisës. Në këtë kuadër del në pah gjithnjë e më tepër zbatimi i Kodit Civil, Kodit Penal, Kodit Tregtar, i ligjit të komunave, etj. Pa dyshim që rritja e kulturës ligjore të shoqërisë shqiptare u mbështet fuqimisht në rritjen e nivelit arsimor të saj, me përmbajtje të theksuar kombëtare.

Përgjithësisht, qeverisja vendore, (prefekturat, nënprefekturat, bashkitë e komunat), i orientuan fondet e tyre financiare në për objektet me interes të përbashkët për komunitetin përkatës, kryesisht në infrastrukturë, punët botore, në shkolla dhe në mënyrë të veçantë në bujqësi. Këto ishin dhe degët e ekonomisë ku ndjehej drejtpërdrejt efektshmëria e qeverisjes vendore, për komunitetin që mbulonin dhe që çonin në ngritjen e nivelit të jetesës së tij.

Ndonëse shkalla e zbatimit dhe e funksionimit të ligjeve bëhej me vështirësi, ekzistenca e tyre ishte një premisë për një të ardhme të sigurtë të zhvillimit modern të shoqërisë shqiptare.

Tërheqja e organizatave të ndryshme të iniciativës private në investime për veprimtari në njësitë vendore, bëri të mundur organizimin dhe funksionimin e shoqatave bamirëse, të cilat ishin fillesat e funksionimit të fondacioneve, në mbështetje të qeverisjes vendore.

Shumë objekte social-kulturore apo administrative, të cilat ruhen deri sot, për nga vlerat e shumta janë identifikuar si monumente kulturore.

Përvoja e organeve të qeverisjes vendore në vitet e Monarkisë Shqiptare përbënte një arritje të gjithë sistemit qeverisës në Shqipëri me prirje të dukshme moderne zhvillimi. Kjo përvojë lipset të hulumtohet e të njihet si e tillë, për t'u zbatuar edhe në ditët tona nga qeverisja vendore si një traditë e pasur.

S u m m a r y

THE ACTIVITY OF THE ALBANIAN LOCAL AUTHORITIES DURING THE MONARCHY YEARS (1928 - 1938)

The sources that throw light on the organization and the activity of local governments are numerous and of a genuine documentary and biographic character.

This work treats the establishment of the monarchy as a form of governing, as a necessity for the overcoming of the archaic situation, the confusion, the disputes and the dishonest war for power.

It is obvious that the greatest responsibility for the organization and the activity of the local governing authorities lies on the Ministry of Internal Affairs, through its function and organization.

The reforms of the local government are seen with quite an interest, especially the transformation of village elders' system into a village chiefs' system, and of the regionalities into sub-prefecture and prefecture.

The process of the reorganization of the local governing authorities went through continuous changing, dictated by the need to adapt it to the conditions of our country.